



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

Nr. 661011 prot

Tiranë, më 10/10 /2017

UDHËZIM

Nr. 663, datë 10/10 .2017

“PËR

MËNYRËN E FUNKSIONIMIT DHE ORGANIZIMIT TË SPORTEELIT UNIK
PËR ADMINISTRIMIN E TË DREJTËS SË AUTORIT – SUADA NË
ADMINISTRIMIN KOLEKTIV”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, e Kushtetutës, të nenit 188, 156 dhe 138, të ligjit nr. 35 datë 31.3.2016, ”Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 35, datë 18.01.2017 “Për mënyrën e funksionimit, të organizimit dhe të shpërblimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit (KKDA)”,

UDHËZOJ:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Përcaktimin e mënyrës së funksionimit dhe organizimit të agjencisë unike për kryerjen e funksionit kolektiv të mbledhjes së tarifave të shpërblimit, në zbatim të nenit 138, të ligjit “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” (në vijim me emërtesën “Sporteli Unik për Administrimin e të Drejtës së Autorit – SUADA”).
2. Objekti i veprimtarisë është kryerja e shërbimeve për funksionin e mbledhjes së tarifave të shpërblimit, në territorin e Republikës së Shqipërisë, për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave në administrimin kolektiv, të mbrojtura nga të gjitha agjencitë e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

administrimit kolektiv të licencuara nga Ministria e Kulturës, sipas nenit 138, të ligjit 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to"

3. Sporteli Unik për Administrimin e të Drejtës së Autorit – SUADA funksionon në përputhje me parimin e transparencës dhe bashkëpunimit me të gjitha AAK-të dhe subjektet përdorues të produktit intelektual.

4. Qëllimi i krijimit të Sporteli Unik për Administrimin e të Drejtës së Autorit – SUADA është sigurimi i një shërbimi eficient dhe të thjeshtuar të subjekteve përdorues si dhe përfitimi në terma të efektivitetit të një sporteli të përbashkët që respekton autonominë në vendimmarrje të AAK-ve të licencuara.

II. STATUSI DHE DETYRAT

1. SUADA krijohet si organizatë jofitimprurëse, person juridik në formën Qendër e cila regjistrohet në gjykatë. Për miratimin e aktit të themelimit, statutit dhe rregullores së organizimit dhe funksionimit të Sporteli Unik për Administrimin e të Drejtës së Autorit – SUADA zbatohet ligji 35/2016 për të drejtën e autorit, ky udhëzim dhe legjislacioni për organizatat jofitimprurëse. Në rast të konfliktit/konkurimit të dispozitave të këtij udhëzimi me aktet e tjera zbatohet ligji për të drejtën e autorit dhe ky udhëzim.

2. Të gjitha AAK-të e licencuara janë anëtare në Këshillin Mbikëqyrës të "Sporteli Unik për Administrimin e të Drejtës së Autorit – SUADA".

3. KKDA, në zbatim të nenit 138, të ligjit 35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to" përzgjedh Agjencinë drejtuese të SUADA e cila caktohet për themelimin dhe regjistrimin për herë të parë të SUADA në gjykatë dhe pajisjen e kësaj qendre me NIPT pranë organeve tatimore. Akti i themelimit, statuti dhe NIPT-i depozitohen pranë Ministrisë së Kulturës. Gjithashtu, kjo AAK drejtuese merr masat për përgatitjen e logos, vulës dhe çdo formati dokumenti që do të përpilohet nga SUADA.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

4. AAK drejtuese e caktuar me vendim nga KKDA, menjëherë pas regjistrimit të SUADA në organet e kërkuara sipas legjislacionit në fuqi e në vijim, vë në dispozicion të SUADA të gjithë burimet e nevojshme (njerëzore, materiale, monetare dhe software-t) për kryerjen e funksionit kolektiv të mbledhjes së tarifave të shpërblimit nga përdoruesit e produktit intelektual.
5. Me fitimin e personalitetit juridik të SUADA asnjë prej AAK-ve të licencuara nuk mund të kryejë individualisht funksionin e mbledhjes së tarifave të shpërblimit në administrimin kolektiv kundrejt subjekteve përdorues. Ky funksion kryhet nëpërmjet SUADA-s sipas parashikimeve të ligjit për të drejtën e autorit, këtij udhëzimi dhe legjislacionit për organizatat jofitimprurëse.
6. SUADA përfaqëson një partneritet të të gjitha AAK-ve, e cila ka si emërtesë “Sporteli Unik për Administrimin e të Drejtës së Autorit – SUADA” dhe logon e përbashkët të përbërë nga logot e të gjitha agjencive të licencuara në administrimin kolektiv.
7. Misioni i SUADA është mbledhja e tarifave të shpërblimit nga subjektet përdorues të veprës së mbrojtur në një sportel unik, në zbatim të vendimit të KKDA-së për miratimin e metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit në administrimin kolektiv. Të gjitha funksionet e tjera, përveç mbledhjes së të ardhurave, realizohen në mënyrë ekskluzive nga vetë AAK-të.
8. SUADA ka detyrimin të zbatojë ligjin e së drejtës së autorit dhe akteve nënligjore në zbatim të saj për dispozitat në lidhje me mbledhjen dhe shpërndarjen e tarifave të shpërblimit për sa këto dispozita janë të aplikueshme në funksion të transparencës, llogaridhënies dhe efencës në veprimtarinë e saj.
9. SUADA ka për detyrë të realizojë mbledhjen kolektive të tarifave të shpërblimit nga subjektet përdorues në mënyrë efektive dhe t’i shpërndajë këto të ardhura tek AAK-të e licencuara në masën e parashikuar sipas ligjit 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

10. Përsa i përket ushtrimit të veprimtarisë së SUADA, nga vlera e të ardhurave që grumbullohen nga subjektet përdorues duhet të zbriten kostot e administrimit. Në kuptim të këtij udhëzimi kosto administrative përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë me realizimin me efektivitet dhe efikasitet të funksionit të mbledhjes së tarifave të shpërblimit nga subjektet përdorues. Pjesa tjetër e të ardhurave shpërndahen tek AAK-të sipas parashikimeve të ligjit 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”. Në çdo rast kjo kosto administrimi e SUADA dhe AAK-ve, së bashku, nuk mund të tejkalojë tavanin e caktuar në nenin 151, të ligjit për të drejtën e autorit deri në 30% të shumave të shpërndara tek kategoritë e mbajtësve të të drejtave të AAK-ve, provuar këto shuma me trasfertat bankare përkatëse.

III. GARANTIMI I TRANSPARENCËS PËR TË GJITHA PALËT E PËRFSHIRA

1. SUADA duhet të garantojë Ministrinë e Kulturës dhe të gjitha AAK-të për transparencë në procesin e vendimmarrjes dhe transparencë të aktiviteteve të përditshme përfshirë ato financiare.
2. SUADA ka për detyrë t’u përgjigjet në kohë të gjitha kërkesave dhe ankesave të palëve të përfshira.
3. SUADA duhet të garantojë veprime etike dhe profesionale kundrejt subjekteve përdorues duke dhënë çdo informacion të nevojshëm dhe shmangur burokracitë e panevojshme gjatë ushtrimit të funksioneve të saj.
4. Në funksion të transparencës, për mbledhjen e të ardhurave nga përdoruesit e veprës së mbrojtur, SUADA hap një llogari bankare të posaçme në një bankë të nivelit të dytë. Personi i autorizuar me të drejtë firme për kryerjen e veprimeve bankare në këtë llogari bankare është përfaqësuesi i organit më të lartë ekzekutiv që përfaqëson Agjencinë drejtuese të SUADA. SUADA përmes Agjencisë drejtuese siguron nëpërmjet dhënies së elementëve të sigurisë (emër përdoruesi dhe password) akses në llogarinë bankare të dedikuar për mbledhjen e tarifave të shpërblimit për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

SUADA, vetëm si shikues por pa të drejtë firme për kryerjen e transaksioneve në këtë llogari bankare. Pasqyrat e lëvizjeve të vlerave monetare në llogarinë bankare të SUADA u vihen në dispozicion të Këshillit Mbikëqyrës dhe Ministrisë së Kulturës, në format elektronik, në intervale 6 mujore të njëpasnjëshme.

5. Faturimet që SUADA bën për subjektet përdorues të produktit të mbrojtur përfshijnë të gjitha tarifat e shpërblimit të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to. Një kopje e librit të shitjeve, hartuar sipas kërkesave të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i jepet për dijeni anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe Ministrisë së Kulturës mbi baza mujore.

6. SUADA publikon në faqen e saj zyrtare pjesën e të ardhurave që i shpërndan secilës AKK, shpërndarje e cila bëhet në përputhje me parashikimet e ligjit 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”.

7. SUADA është subjekt i të gjitha detyrimeve për të siguruar transparencën, për sa parashikohet në ligjin 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” dhe ligji 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për atë që vlerësohet e përshtatshme apo parashikohet ndryshe në këtë udhëzim. SUADA publikon në faqen e vet zyrtare

- statutin;
- emrat e përfaqësuesve të secilës AAK anëtar i SUADA;
- listën e subjekteve përdoruesve apo të shoqatave të përdoruesve ;
- kontratat e lidhura me secilin prej tyre,;
- shumën e të ardhurave të mbledhura;
- kostot administrative;
- vendimet e mbledhjeve,
- të dhëna të tjera për të siguruar transparencën ndaj të tretëve.

8. Në fund të periudhës raportuese, SUADA së bashku me publikimin e pasqyrave financiare vjetore, publikon edhe raportin e ecurisë së veprimtarisë ku analizohet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

performanca në realizimin e misionit të saj. Raporti i ecurisë si dhe të informacioneve të tjera për efikasitetin dhe efektivitetin e veprimtarisë së saj, të kërkuara nga KKDA dhe Ministria e Kulturës, janë baza për kontrollin e performancës së AAK-së drejtuese për të qenë e tillë edhe në periudhën pasardhëse. Konsiderohet performancë e dobët e Agjencisë drejtuese të SUADA:

- Një nivel më i ulët i mbledhshmërisë së të ardhurave krahasuar me mesataren e dy viteve të fundit kalendarike kur është ngarkuar me këtë funksion;
- faktet e vërtetuara nga ana e KKDA-së për abuzime të përsëritura dhe mungesë të ofrimit të shërbimeve ndaj subjekteve përdorues;
- shkelje të ligjit për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë.

9. Buxheti i parashikuar i kostove administrative hartohet nga Agjencia drejtuese e SUADA dhe miratohet nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës të SUADA mbi baza 6 mujore. Buxheti faktik i kostove administrative hartohet nga sekretaria teknike e SUADA mbi baza 6 mujore dhe i'u dërgohet për dijeni anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të SUADA.

10. SUADA përcakton mënyrat e komunikimit reciprok me KKDA-në dhe Ministrinë e Kulturës, Këshillin Mbikëqyrës si dhe llojin e informacionit të detyrueshëm për t'u shkëmbyer.

11. SUADA ka pronësinë e bazës së të dhënave dhe software-t që përdoren për të realizuar mbledhjen kolektive të të ardhurave.

IV. FUNKSIONIMI DHE ORGANIZIMI

1. Organi më i lartë vendimmarrës në lidhje me garantimin e transparencës të mbledhjes dhe shpërndarjes së të ardhurave që realizohet nga SUADA është Këshilli Mbikëqyrës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

2. Këshilli Mbikëqyrës i SUADA përbëhet me përfaqësues të AAK-ve të licencuara. Secila prej AAK-ve ka 1 (një) përfaqësues anëtar në Këshillin Mbikëqyrës të cilët e ushtrojnë këtë funksion pa shpërblim.
3. Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës së SUADA në mënyrë simbolike është përfaqësuesi i AAK-së më të parë të themeluar në administrimin kolektiv në Shqipëri.
4. Këshilli Mbikëqyrës ushtron funksionet si më poshtë:
 - Miratimin e planeve dhe veprimtarinë mujore të organit më të lartë ekzekutiv të SUADA për detyrat që kryen për llogari të funksionit kolektiv të mbledhjes së të ardhurave;
 - Miratimin e rregullores së organizmit dhe funksionimit të SUADA;
 - Miratimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me organet e tjera shtetërore;
 - Miratimin e mënyrës për vënien në dispozicion të informacionit mbi veprimtarinë e SUADA, kostove administrative, ankesave të subjekteve përdorues, pasqyrave financiare, lëvizjes së vlerave monetare tek palët e interesuara, etj;
 - Shqyrtimin e ankesave të AAK-ve pjesë të Këshillit Mbikëqyrës;
 - Miratimin e formatit të dokumentacionit që i vihet në dispozicion subjekteve përdorues;
 - Kompetenca të tjera statutores në lidhje me transparencën për mbledhjen e tarifave të shpërblimit nga shfrytëzimi i produktit të mbrojtur dhe shpërndarjen e tyre tek AAK-të.
5. Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës zbatohen nga ana e drejtuesit të organit më të lartë ekzekutiv të Agjencisë drejtuese të SUADA. Rregullat e veprimtarisë dhe detyrave të organit më të lartë ekzekutiv për funksionin si Agjenci drejtuese e SUADA përcaktohen nga statuti i SUADA në përputhje me këtë udhëzim dhe legjislacionin për organizatat jofitimprurëse.
6. Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës miratohen me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të tij. Kuorumi i Këshillit Mbikëqyrës konsiderohet i vlefshëm kur në mbledhje marrim pjesë jo më pak se 3/4 e anëtarëve të tij.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

7. Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës merren me votim të hapur dhe duhet të jenë të arsyetuara. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës në mbledhje dhe që nuk kanë ndonjë pengesë ligjore apo rrethana të tjera për të votuar, nuk mund të abstenojnë.
8. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës që janë të pranishëm në mbledhje, diskutojnë dhe votojnë për vendimmarrjen e një çështjeje të caktuar, me përjashtim të rasteve kur kanë pengesë ligjore në kuptim të nenit 30 të ligjit Nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative", të konfliktit të interesit, diskriminimit ose rasteve të tjera të ndaluara me ligj. Në këto raste, anëtari i Këshillit Mbikëqyrës njofton Kryetarin për mospjesëmarrjen në diskutimin dhe votimin e çështjes së caktuar që pritet të zhvillohet në mbledhjen e Këshillit Mbikëqyrës.
9. Përfaqësuesi i Agjencisë drejtuese të SUADA voton i fundit. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë, vota e tij është vendimtare. Vendimet nënshkruhen nga anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës pjesëmarrës në mbledhje.
10. SUADA publikon në vendimin e marrë edhe mendimin e arsyetuar të anëtarit/anëtarëve që kanë votuar në pakicë dhe shënon në procesverbal faktin dhe arsyet e votimit kundër të vendimit.
11. Në rastet e dorëheqjes, ndërprerjes së mandatit apo çdo rrethane tjetër që e pamundëson votimin e anëtarit në mbledhje në procedurën përpara SUADA, vendimi merret me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve në detyrë. Në rastet kur rezultati i votimit është i barabartë, vota e përfaqësuesit të Agjencisë drejtuese të SUADA përbën shumicën absolute të vendimmarrjes.
12. Me qëllim transparencën e aktivitetit të SUADA, krijohet sekretaria teknike e cila arshivon korespondencën, koordinon qarkullimin e informacionit dhe mban procesverbalin e mbledhjeve, i cili përfshin:
 - a) orën, datën, vendin e mbledhjes;
 - b) listëprezencën e pjesëmarrësve në mbledhje;
 - c) çështjet e diskutuara nga anëtarët;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

- ç) formën dhe rezultatin e votimeve;
- d) çdo informacion apo dokument objekt diskutimi dhe vendimarrjeje.

Kostot e stafit të sekretarisë teknike janë pjesë e kostove administrative.

13. SUADA ka detyrimin që së bashku me subjektet përdorues të produktit të mbrojtur të verifikojë në çdo kohë, me kërkesë të këtyre të fundit, saktësinë e informacionit dhe të llogaritjes së detyrimit për përdorimin e veprës së mbrojtur, sipas vendimit të KKDA-së për miratimin e metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit në administrimin kolektiv. Çdo veprim i llogaritur gabim apo çdo vlerë e ndryshuar për shkak të rrethanave të ndryshme që rëndon pozitën financiare të subjekteve përdorues duhet të jetë objekt i menjëhershëm i korigjimit nga ana e SUADA me kostot e saj.

14. SUADA ka detyrimin të shqyrtojë kërkesat dhe ankesat e secilës AAK në Këshillin Mbikëqyrës që kanë lidhje me objektin e funksionimit të saj.

V. ASPEKTE TË TJERA FINANCIARE DHE TATIMORE

1. Të ardhurat e arkëtueshme nga SUADA janë ato të llogaritura sipas vendimit të KKDA për miratimin e metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit në administrimin kolektiv.

2. Faturimet e SUADA për subjektet përdorues, në mbështetje të ligjit, janë faturime me TVSH. Për të mos krijuar probleme të pagesës së TVSH-së së mbledhshme përpara arkëtimit të tarifës nga përdoruesit e veprës së mbrojtur, SUADA lidh një marrëveshje me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve (DPT) ku miratohet lëshimi i faturës “proforma” nga SUADA për subjektin përdorues dhe më pas, me arkëtimin e shumës prej tij, SUADA përpilon, lëshon dhe deklaron faturën përkatëse me TVSH. Pjesë e marrëveshjes me DPT mund të jenë edhe çështje të tjera me qëllimin e vetëm transparencën dhe intensifikimin e politikave për formalizimin e mëtejshëm të administrimit kolektiv në vendin tonë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

3. Ndryshe nga sa parashikohet në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 120, pavarësisht vlerës së faturës, shlyerja e saj nga subjekti përdorues i produktit intelektual bëhet vetëm përmes llogarisë bankare të SUADA. Në të kundërt, veprimi konsiderohet i parregullt dhe cënon cilësinë e transparencës.
4. Referuar ligjit nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, SUADA në cilësinë e agentit tatimor, llogarit, mbledh dhe derdh në Buxhetin e shtetit TVSH-në përkatëse të të ardhurave të mbledhura nga subjektet përdorues të produktit të mbrojtur.
5. Shuma që i’u shpërndahet AAK-ve për shpërblimin e anëtarëve që ata përfaqësojnë është e zhveshur nga TVSH-ja. Kësaj shume përpara shpërndarjes i zbritet shuma e nevojshme për përballimin e kostove administrative. Zërat e kostrove administrative të SUADA përcaktohen në statutin e saj në përputhje me parimin e efikasitetit dhe transparencës.
6. Referuar ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, është përgjegjësi tatimore e vetë AAK-ve në cilësinë e agentit të mbajtjes së tatimit në burim, të llogarisin, mbajnë dhe derdhen në buxhetin e shtetit shumën e tatimit në burim që i’u mbahet përfituesve nga e drejta e autorit mbi shumën e arkëtueshme.

VI. OFRIMI I SHËRBIMIT NGA SUADA

1. SUADA përmes Agjencisë drejtuese për realizimin e veprimtarisë së saj ngarkohet të përfundojë ngritjen e rrjetit të zyrave të përfaqësimit, me të paktën një zyrë në çdo qark, duke u kujdesur që mjediset e zgjedhura të jenë lehtësisht të mbërritshme, në vende të dukshme, me elemente të dallueshëm identifikues në mjediset e brendshme dhe të jashtme (tabela, logo, uniforma, etj) si dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme ku



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

një staf profesional ofron të gjithë gamën e shërbimeve sa më eficiente, pa burokraci për subjektet përdorues.

2. Në rastet kur është e mundur, për realizimin e funksionit kolektiv të mbledhjes së të ardhurave, mund të shfrytëzohen edhe mjediset e Drejtorive Rajonale Kombëtare të Kulturës në territor si dhe ambiente të institucioneve të tjera në bazë të marrëveshjeve përkatëse.

3. Ministria e Kulturës për lehtësimin e procedurave dhe bashkëpunimit me subjektet përdorues të produktit të mbrojtur në administrimin kolektiv lidh marrëveshje me Agjencinë Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe SUADA. Kjo marrëveshje bashkëpunimi angazhon palët për të mundësuar për subjektet përdorues ofrimin e shërbimive të njohjes me dokumentet përkatëse dhe plotësimin e tyre nëpërmjet portalit të shërbimeve E-Albania, për funksionin e llogaritjes dhe kryerjes së pagesave të tarifave të shpërblimit në SUADA. Në këtë marrëveshje përfshihet edhe çdo shërbim tjetër që garanton dhe thjeshton përmbushjen e detyrimeve ndaj subjekteve përdorues nga njëra anë dhe transparencën për publikun nga ana tjetër.

4. SUADA përmes Agjencisë drejtuese për realizimin e veprimtarisë së saj ngarkohet, që brenda 60 ditëve, të krijojë një faqe interneti të veçantë për të publikuar çdo informacion, dokumentacion, formularët e vetdeklarimit, aktivitet dhe gjithçka tjetër vlerësohet e nevojshme në lidhje me transparencën dhe nxitjen e marrëdhënieve të bashkëpunimit me subjektet përdorues, AAK-të dhe institucionet shtetërore për realizimin e funksionit kolektiv të mbrojtjes së të ardhurave. Ky website shfaqet si link në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës.

5. SUADA përmes Agjencisë drejtuese për realizimin e veprimtarisë së saj ngarkohet të mundësojë infrastrukturën e nevojshme për funksionimin e këtij shërbimi online të përditësimit të të dhënave të subjekteve përdorues, të përditësimit të repertorit të mbrojtur, të llogaritjes së tarifave të pagueshme, të pranimit (upload) përmes faqes së internetit të evidencës së përdorimit të veprave të mbrojtura nga subjektet përdorues, e të



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

tjera shërbime online sipas nevojës me qëllim reduktimin e kohës së transaksioneve, numrit të kontakteve direkte, kostos së formave të tjera të komunikimit dhe kostos mjedisore të materialeve të printuara.

VII. MBIKËQYRJA E SUADA

1. Në zbatim të ligjit 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” Ministria e Kulturës dhe KKDA kryejnë inspektime periodike ose edhe kryesisht, të aktivitetit të SUADA të paktën një herë në vit.
2. Në rast konstatimi të shkeljeve apo parregullsive ato i bëhen të njohura të gjitha AAK-ve të përfaqësuara në SUADA dhe organeve kompetente.

VIII. ZGJIDHJET E KONFLIKTEVE

1. SUADA në statutin e vet përcakton klauzolat për rastet e konflikteve sipas të cilave disa ose të gjitha konfliktet mes AAK-ve dhe SUADA ose mes kësaj të fundit dhe subjekteve përdorues.
2. Është përgjegjësi e SUADA përmes Agjencisë drejtuese ndjekja e kryerjes së procedurave gjyqësore, administrative si dhe atyre të përmbarimit.

IX. HYRJA NË FUQI

1. Ngarkohet SUADA përmes Agjencisë drejtuese, e caktuar me vendim të KKDA për ushtrimin e funksionit të mbledhjes së tarifave të shpërblimit për të gjitha kategoritë e mbajtësve të të drejtave në administrimin kolektiv, në zbatim të nenit 138 të ligjit 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to” dhe AAK-të e licencuara për zbatimin e këtij udhëzimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR PËR TË DREJTËN E AUTORIT

2. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës si dhe në Fletore Zyrtare.
3. Ngarkohet sekretariati teknik i Këshillit Kombëtar për të Drejtën e Autorit për njoftimin e këtij udhëzimi.



MINISTRI

MIRELA KUMBARO FURXHI